

# PHILIPS

## Kufjet

Seria 6000

TAH6005



# Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin dhe merrni ndihmë në  
[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

# Përmbajtja

|   |                                                 |   |
|---|-------------------------------------------------|---|
| 1 | Udhëzime të rëndësishme<br>sigurie              | 2 |
|   | Siguria e dëgjimit                              | 2 |
|   | Informacione të përgjithshme                    | 2 |
| 2 | Kufjet me valë për televizor                    | 3 |
|   | Çfarë ka në kuti                                | 3 |
|   | Përmbledhje për kufjet me<br>valë për televizor | 4 |
| 3 | Fillimi                                         | 5 |
|   | Nisja                                           | 5 |
|   | Lidhje                                          | 6 |
|   | Treguesit LED                                   | 7 |
| 4 | Të dhëna teknike                                | 8 |
| 5 | Pyetje të bëra shpesh                           | 9 |

# 1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

## Siguria e dëgjimit



### Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin e të dëgjuarit, kufizoni kohën që përdorni kufjet në volume të larta dhe vendoseni volumnin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumni, aq më e shkurtër është koha e dëgjimit të sigurt.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur përdorni kufjet.

- Dëgjoni me volumn të arsyeshëm dhe për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e ngrini vazhdimisht volumnin ndërsa mësoheni me dëgjimin.
- Mos e ngrini volumnin aq shumë sa të mos dëgjoni çfarë ndodh rreth jush.
- Duhet të tregoni kujdes ose duhet të mos i përdorni përkohësisht kufjet në situata që mund të jenë të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i zërit nga kufjet mund të shkaktojë humbjen e dëgjimit.
- Nuk rekomandohet përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar ndërsa drejtoni automjetin, dhe kjo mund të jetë e paligjshme në disa zona kur drejtoni automjetin.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik apo në vende që mund të jenë të rrezikshme.

## Informacione të përgjithshme

Për të shmangur dëmtimin ose defektet:



### Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet dhe transmetuesin në nxehtësi tepër të lartë.
- Mos i rrëzoni kufjet dhe transmetuesin.
- Kufjet dhe transmetuesi nuk duhet të ekspozohen ndaj pikave dhe spërkatjeve të ujit.
- Mos lejonit që kufjet dhe transmetuesi të zhyten në ujë.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, benzinë, ose gërryes.
- Nëse nevojitet pastrim përdorni një leckë të butë, dhe nëse është e nevojshme, me pak ujë ose detergjent të lehtë të holluar për ta pastruar produktin.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt siç është drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar në mënyrë të gabuar. Ndërrojeni vetëm me të njëjtin tip ose me tip ekuivalent.

Lidhur me temperaturat dhe lagështinë gjatë përdorimit dhe ruajtjes

- Përdoreni ose ruajeni në një vend ku temperatura është midis  $-10^{\circ}\text{C}$  ( $14^{\circ}\text{F}$ ) dhe  $60^{\circ}\text{C}$  ( $140^{\circ}\text{F}$ ) (lagështia relative deri në 90%).
- Jeta e baterisë mund të jetë më e shkurtër në temperatura të larta ose të ulëta.

## 2 Kufjet me valë për televizor

Urime për blerjen tuaj dhe mirësevini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).


Me kufjet over-ear të Philips ju mund:

- të kënaqeni ndërsa shihni e dëgjoni me anë të valëve shfaqjet televizive;
- të dëgjoni dhe të kontrolloni muzikën me anë të valëve.

### Çfarë ka në kuti



Kufjet




Transmetuesi




Tubi i antenës





2 bateri të karikueshme AAA



Kablli i audios 3.5 mm



Adaptori AC/DC



Spinë e ndryshueshme për spinë UK dhe GS



Udhëzues i shkurtër




Garancia botërore



Fletëpalosje sigurie

## Përmbledhje për kufjet me valë për televizor



- ① Treguesi LED
- ② Spina 3.5mm për karikimin e kufjeve
- ③ Hyrja e energjisë
- ④ Çelësi i zgjedhjes së kanalit
- ⑤ Audio in (lidhje me televizor)
- ⑥ Ndezja / fikja
- ⑦ Priza e karikimit
- ⑧ LED
- ⑨ Kërkimi automatik (pas zgjedhjes së kanalit te transmetuesi)
- ⑩ Volumi +/-

## 3 Fillimi

### Kujdes


- Bateritë alkaline AAA mund të përdoren për kufjet, por nuk mund të karikohen bashkë me këtë sistem.

### Shënim


- Përdorni vetëm bateri Philips të shkurtra NiMH të karikueshme me kufjet tuaja. Nuk lejohet të përdoren lloje të tjera baterish me këtë sistem.
- Para se t'i përdorni kufjet për herë të parë, karikojini bateritë e dhëna për të paktën 5 orë.
- Nëse volumni i burimit audio nuk mjafton, transmetuesi fiket automatikisht.
- Transmetuesi nuk transmeton sinjal audio kur e karikoni baterinë.

## Nisja


- 1 Vendoseni tubin e antenës në transmetues.




- 2 Lidhni adaptorin e energjisë me prizën e energjisë dhe spinën 3.5 mm me transmetuesin.



- 3 Tërhiqeni mbështetësen e veshit në anën e majtë të kufjes. Vendosni dy bateritë AAA të dhëna.



- 4 Lidhni kabllin e karikimit me prizën e karikimit në kufje për t'i karikuar kufjet. LED në transmetues do të pulsojë ngjyrë "JESHILE". Kur karikimi të ketë përfunduar, drita LED do të qëndrojë ndezur ngjyrë "JESHILE" në transmetues.




Po karikohet: drita “jeshile” pulson;  
Karikimi ka përfunduar: drita “jeshile”  
qëndron ndezur.

## Lidhje

### 1 Lidhja e pajisjes audio

- Lidheni pajisjen audio me një dalje 3.5mm. Lidheni njërën anë të kabllit audio 3.5 mm të dhënë me hyrjen audio 3.5 mm të transmetuesit dhe anën tjetër me daljen 3.5 mm audio.



### 2 Ndezja e kufjeve

- Shtypni butonin e energjisë në kufje. Drita LED do të ndizet në ngjyrë “JESHILE” në kufje.



### 3 Rregulloni volumin e hyrjes


- Për pajisjet me dalje 3.5mm (p.sh. televizor), ngritja e volumit në kufje nuk vlen nëse niveli i volumit të pajisjes së lidhur është tepër i ulët.

### 4 Kërkimi automatik

- Shtypni butonin e kërkimit automatik në kufje për të bërë automatikisht një kërkim të dytë në kanal in e sinjaleve.



- Zgjidhni kanalin më të mirë
- ↳ Nëse ka interferencë, kaloni në një kanal tjetër në transmetues. Më pas shtypni butonin e kërkimi automatik në kufje për të përsëritur kërkimin.



## Treguesit LED

| Statusi                        | Drita LED në transmetues          | Drita LED në kufje               |
|--------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------|
| Duke kërkuar                   | Nuk zbatohet                      | Drita LED jeshile pulson         |
| Lidhja u krye                  | Drita LED e bardhë është e ndezur | Drita LED jeshile e ndezur       |
| Niveli i baterisë është i ulët | Nuk zbatohet                      | Drita LED jeshile pulson ngadalë |
| Po karikohet                   | Drita LED jeshile pulson          | Nuk zbatohet                     |
| Është karikuar plotësisht      | Drita LED jeshile e ndezur        | Nuk zbatohet                     |



### Këshillë

- Drita LED e bardhë në transmetues fiket pas 5 minutash.



## 4 Të dhëna teknike

### Specifikime dhe veçori të përgjithshme

- Koha e muzikës (variacion i kufjeve): 18 orë
- Koha normale për një karikim të plotë: 6 orë
- Distanca e funksionimit: deri në 100 metra (ambient i hapur)
- Zgjidhja FM

### Transmetimi

- Rrjeti / frekuenca: 863.53-864.53 MHz
- Fuqia e transmetimit: <9 dBm

### Bateria

- 2 bateri të karikueshme AAA NiMH 700

### Adaptori

- Philips: YLJXC-080040
- Input: 100-240 v~, 50/60 Hz
- Output: 8 vdc 400 mA



### Këshillë

Për ndihmë të mëtejshme lidhur me produktin, ju lutemi vizitoni [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).

## 5 Pyetje të bëra shpesh

### Nuk dëgjoj zë.

- Sigurohuni që t'i lidhni si energjinë dhe adaptorin (shiko "1. Lidhja e pajisjes audio" në faqen 5).
- Sigurohuni që ta rregulloni volumnin në nivel të përshtatshëm.
- Sigurohuni që bateritë të jenë të karikuara dhe të vendosura mirë në vendin e karikimit të baterisë (shiko "Fillimi" në faqen 5).
- Kontrolloni nëse drita LED në transmetues është ndezur në ngjyrë të bardhë.
- Bateritë janë me defekt. Blini bateri të reja me të njëjtat specifkime.

### Tingulli nuk del i pastër.

- Niveli i volumnit në burimin e audios është vendosur tepër lart.
- Kufjet janë pothuajse jashtë distancës së lejuar. Afrojini me transmetuesin.
- Kufjet marrin interferencë nga pajisjet elektrike pranë. Largojeni transmetuesin prej tyre.
- Kufjet ndodhen në një vend me mure të trashë. Largojeni transmetuesin prej tyre.
- Rregulloni konfigurimin e kanalit (shiko "Fillimi" në faqet 6-7).
- Rregulloni volumnin e pajisjes audio.

### Kur e lëviz kokën, dëgjoj zhurmë interferuese.

Interferenca mund të shkaktohet nga një pajisje tjetër me valë, si pajisje Bluetooth, WiFi, router 2.4 GHz. Largojeni pajisjen me valë.

### Cilësia e audios është e dobët.

- Kufjet janë tepër larg. Afrojini kufjet me pajisjen audio, ose hiqni pengesat mes tyre.
- Rregulloni konfigurimin e kanalit (shiko "Fillimi" në faqet 6-7).
- Rregulloni volumnin e pajisjes audio.

### Sipas të dhënave, distanca e funksionimit është deri në 100 metra. Pse distanca e vërtetë është më e shkurtër?

Distanca e funksionimit ulet nga pengesat, si muret e trashë, dyert ose tavanet. Afrojini kufjet me transmetuesin.

Për ndihmë të mëtejshme, vizitoni [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).



Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet me përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

UM\_TAH6005\_10\_SQ\_V1.0

